*(iii) **Z. Agim Zeqo** do te perfitoj prej cdo aksionari te shoqerise "Digitalb" **2.88%** te aksioneve qe ai ka ne shoqerine "Digitalb" sh.a;*

(iv) Z. Samir Mane do te perfitoj prej cdo aksionari te shoqerise "Digitalb" 2.88% *te aksioneve qe ai ka ne shoqerine "Digitalb" sh.a.*

D. Për të siguruar përmbushjen e detyrimit të mësipërm, të gjithë Aksionarët Digit-Alb sh.a, kanë barresuar keto aksione sipas Marreveshjes Siguruese me Nr.4848/2737 dhe datë 18.12.2015 pranë Regjistrit të Barrës Siguruese në favor të Blerësve me Kusht dhe do të qëndroj e regjistruar si e tillë deri në momentin e përmbushjes se te gjitha detyrimevesiguruara. Kjo marveshje është depozituar sipas kerkesave ligjore edhe pranë QKB-së.

E. Blerësit me Kusht (respektivisht përfitues të përqindjes së aksione të cilësuara në pikën C mësipër), kanë rënë dakort që në datën 01.01.2010 ose edhe më parë, të shlyejme çmimin e shitjes duke bërë

Neni 3 – Angazhimet dhe garancitë e AZ-së/Ceducsi

3.1 Nëse do të konsiderohet e nevojshme nga AG dhe nëse Aksionari Digitalb z.Jaho i kundrejtojnë AG prapësime ne lidhje me të drejtat mbi Aksionet Digitalb z.Jaho apo ato të ceduara sipas kësaj Marrëveshje, AZ është i gatshëm të veprojë ne emër të vet, por për llogari, në interes dhe me shpenzimet AG për kalimin e plotë të të drejtave të pronësisë mbi Aksioneve Digitalb z.Jaho të ceduara sipas kësaj Marrëveshje

3.2 Në momentin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, AZ i garanton AG-s ekzistencën e të drejtave të ceduara mbi Aksionet Digitalb z. Jaho dhe deklaron se të drejtat e ceduara janë të kërkueshme, në përputhje me c'ka deklarohet ne parakushte.

3.3 Të drejtat e ceduara mbi Aksionet Digitalb z.Jaho janë në disponibilitetin e tij të plotë të AZ dhe nuk është ceduar tek të tretë.

3.4 Aksionari Digitalb z.Jaho nuk kanë të drejta të së njëjtës natyrë ndaj AZ të cilat kund të kundrejtohen AG duke pretenduar kompensim.

3.5 Nuk eksiston asnjë dakordësi midis AZ dhe Aksionarit Digitalb z.Jaho që kufizon apo pengon cedimin e drejtave sipas kësaj Marrëveshje.

3.6 Të drejtat e ceduara sipas kësaj Marrëveshje dhe të drejtat reale mbi to transferohen *ex lege* pa qënë e nevojshme të kryhen formalitete të tjera, përveç nënshkrimit të kësaj Marrëveshje.

Neni 4 – Zgjidhja e Marrëveshjes

4.1 AZ ka të drejtë të zgjidh këtë Marrëveshje sipas nenit 702 të Kodit Civil, pacënuar këtu edo të drejtë dëmshpërblimi AZ, vetem nëse AG nuk paguan ose vonojnë të kryejë pagesen e kundërshperblimit të percaktuar në nenin 2 të kësaj Marrëveshje.

4.2 AG ka të drejtë të zgjidh këtë Marrëveshje sipas nenit 702 të Kodit Civil, pacënuar këtu edo të drejtë dëmshpërblimi AG, nëse garancitë e dhëna sipas nenit 5 të kësaj Marrëveshje do të zbulohen si plotësisht apo pjesërisht të paqena dhe gjithësesi të atilla që të mos lejojnë trasferimin e pronësisë mbi të drejtat e ceduara (Aksionet Digitalb z.Jaho).

4.3 Në rastet e parashikuara në piken 6.1 dhe 6.2 mesiper, pala e interesuar do t'i kumonikojë Palës tjetër zgjidhjen e Marrëveshjes me letër rekomande me kthim pergjigje. Palët pranojnë dhe deklarojnë se Marrëveshja do të konsiderohet e zgjidhur me efekte të plota e të mënjëhershme në momentin e marrjes së njoftimit nga pala tjetër.

Neni 5 – Të ndryshme

5.1 Kjo Marrëveshje përbën Marrëveshjen e plotë ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e saj dhe zëvendëson e ka përparësi ndaj të gjitha kontratave, marrëveshjeve ose angazhimeve të mëparshme me të njëjtin objekt.

5.2 Asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshje nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk kryhet me shkrim dhe nënshkruhet nga Palët.

5.3 Kjo Marrëveshje do të jetë e detyrueshme dhe do të ketë pasoja juridike ndaj Palëve, trashëgimtareve të tyre, si dhe ndaj atyre të cilëve iu është ceduar në mënyrë të rregullt.

5.4 Kjo Marrëveshje rregullohet dhe intrepretohet në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

5.5 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të ketë kompetence ekskluzive në lidhje me te gjitha mosmarrëveshjet e lindura midis Palëve ne lidhje me ketë Marrëveshje.

5.6 Të gjitha komunikimet, njoftimet dhe lajmërimet e kërkuara apo lejuara nga kjo Marrëveshje do të kryhen me shkrim dhe do të dorëzohen dorazi ose me letër rekomande me kthim përgjigje ose nëpërmjet një shërbimi postar që siguron provë të dërgesës në adresat e mëposhtme, me përjashtim të dhe deri kur njëra nga Palët t'i njoftojë Palës tjetër, një ndryshim të adresave më fjalë:

A. Për **Agim Zeqo** – në adresën e sipërshënuar apo në një adresë tjetër do të komunikohet nga kjo palë në vijim për këtë qëllim;

B. Për **Alba Gina** — në adresën e sipërshënuar apo në një adresë tjetër do të komunikohet nga palë në vijim për këtë qëllim.

TIRANA BANK

KODI FISKAL/FISCAL CODE: 3607408 NIPT/TAXE CODE: J61924008 V

Transferte midis Llogarive ne monedhe te njejte / Same Currency Account Transfer

Dega/Branch:	Data/Date :	Ora/Time :	Arketari/Teller :	Trnx ID :
TIRANA 3 Bryli	02/12/2021	15:07:42	B168	0000115990001

Detajet te llogarive/Account details

Klienti qe debitohet/Debit Customer :

GINA ALBA,AGIM
120016

Date Valuta /Value Date
02/12/2021

Numri i llogarise: 0110120016002
Emri i llogarise: GINA A.A.
IBAN: AL14206110110000110120016002

		Shuma/Amount
Shuma Debitore/ Debit Amount :	EUR	6,000.00
Komisioni/ Commission:	EUR	0.00
Shuma Kreditore/ Credit Amount :	EUR	6,000.00

Pershkrimi/Details:
013000001159900
TRN PER ZEQO AGIM,NAZMI
SIPAS MARREV.DT.29.11.21

Klienti qe kreditohet/Credit Customer :

ZEQO AGIM,NAZMI
170101

Date Valuta /Value Date
02/12/2021

Numri i llogarise: 0115170101002
Emri i llogarise: ZEQO A.N.
IBAN: AL50206111070000115170101002

Pershkrimi/Details
TRN NGA GINA ALBA,AGIM
SIPAS MARREV.DT.29.11.21

TIRANA BANK
02 DEK 2021
TELLER # 2

Emer Mbiemer / Firma e Klientit
Customer Signature

Bank Authorized Signatures
Firma/t e Autorizuar/a te Bankes

Me nenshkrimin e ketij dokumenti una deklaroj se fondet e perdorura burojne nga aktivitete te ligjshme dhe nuk perfaqesojne veprim i cili nuk eshte ne perputhje me ligjin. Banka nuk mban pergjegjesi per gabimet qe rjedhin nga instruksionet e pasakta te urdheruesit.

TIRANA BANK

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

NR.REGJ.THEM. 10348/2942/1283 DATE 25.10.2021

DT.REGJ. 03.04.2019

VENDIM
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

Alma KODRALIU – GJYQTARE

Asistuar nga **Sekretare Gjyqesore Gencjana Dada,** sot me datë 25.10.2021, mori në shqyrtim, kërkesën për heqjen e masës për sigurim padie lidhur me çështjen civile që i përket:

PADITËS: Shoqëria "DIGIT-ALB" sh.a me seli në Tiranë, Kashar, Rruga "Pavarësia" nr. 39, identifikuar nga Nipt me Nr. K 41719004 D përfaqësuar nga znj. Vjollca Hoxha dhe z.Arben Taipi, në cilësinë e administratorëve. e-mail: Vjollca. Hoxha@digitalb.tv përfaqësuar në gjykim me autorizim përfaqësimi me nr. 441 prot datë 01.04.2019 nga z. Redi Lamaj dhe në referim të prokurës së përgjithshme me nr. 4450 rep, nr. 893 kol, datë 01.10.2019 nga av. Ilir Dode me nr.licence 5216, nr.nipti L 21402505 P, anëtar i dhomës së avokatisë Tiranë.

I PADITUR: Alban Jaho i biri i Nuriut dhe Nazmies, i dtl 31.05.1969, lindur dhe banues në Tiranë në adresën: Rruga "Vaso Pasha", Pall nr. 31, Apartamenti nr. 4, përfaqësuar në gjykim me deklarim nga av. Neshat Fana me nr. licence 929, nr. nipti L 52212081 M, anëtar i dhomës së avokatisë Tiranë.

OBJEKTI: - Zhdëmtimin e dëmit 100.000 (njëqind mijë) Euro që ish administratori i shoqërisë "Digitalb" sh.a, Alban JAHO me veprimet dhe vendimarrjet e tij si administrator i ka shkaktuar shoqërisë "Digitalb" sh.a. - Lejimin e masës së sigurimit të padisë,

duke urdhëruar vendosjen e sekuestros mb aksionet që Alban Jaho si aksioner ka dhe zotëron në shoqërinë "Digitalb" sh.a.

BAZA LIGJORE: Nenet 14, 16 dhe 163 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregëtare" (i ndryshuar). Nenet 32 gërma "a", 154, 202-206 të Kodit të Proçedurës Civile.

VËREN :

Palët paditëse i janë drejtuar kësaj gjykate me padinë e mësipërme, pjesë e së cilës ishte dhe kërkesa për marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke urdhëruar vendosjen e sekuestros mbi aksionet që i padituri Alban Jaho zotëron si aksioner i palës paditëse.

Pala paditëse, Shoqëria "DIGITALB" sh.a është regjistruar si person juridik që prej datës 18.05.2004 me objekt të veprimtarisë së saj tregtare në fushën e : "Ndërtim, tregtim, të sistemeve të telekomunikacioneve...etj". Referuar përmbajtjes së ekstraktit të sipërcituar rezulton që i padituri në këtë gjykim Alban Jaho të ketë ushtruar funksionin e administratorit të shoqërisë "DIGIT - ALB" sh.a deri më datë 17.01.2019 për shkak se në referim të vendimit të asamblesë së aksionarëve datë 17.01.2019 shtë vendosur: "Largimi nga detyra e administratorit Z. Alban Jaho". 2. Referuar përmbajtjes së kërkesë- padisë së paraqitur nga pala paditëse shoqëria "DIGIT - ALB" sh.a rezulton që kjo e fundit të ketë pretenduar se i padituri në këtë gjykim Alban Jaho gjate periudhës që ka ushtruar funksionin e administratorit të shoqërisë i ka shkaktuar dëm shoqërisë "Digit - Alb" sh.a në shumën 100.000 (njëqind mijë) Euro.

Sipas pretendimeve të palës paditëse një dëm i tillë ishte shkaktuar si rezultat i faljes së një detyrimi prej 100,000 (njëqind mijë) Euro që i padituri në këtë gjykim Alban Jaho i kishte bërë shoqërisë "Tibo", detyrim ky i cili rridhte nga marrëdhënia kontraktore që shoqëria "Digit - Alb" kishte pasur me shoqërinë "TIBO".

Lidhur me këtë padi, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane me Vendim "Per marrjen e mases se sigurimit te padise Nr.Regj.Them.7596 (Dt.Regj. 03.04.2019) date 14.06.2019, vendosi: Pranimin e kerkeses se pales paditese Digitalb sh.a. 1. Vendosjen e sekuestros conservative mbi aksionet qe i padituri Alban Jaho zoteron ne shoqerine Digitalb sh.a. perkundrejt vendosjes si garanci pasurore nga ana e pales paditese shoqerise Digitalb sh.a. te shumes 20 000 Euro shume kjo e cila duhet te depozitohet nga ana e pales paditese shoqerise Digitalb sh.a. ne nje nga bankat e nivelit te dyte ne RSH per llogari te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me pershkrimin:"Per sigurimin e padise". 2. Masa e sigurimit te padise do ti shtrije efektet e veta nga data e depozitimit te shumes se sipercituar nga pala paditese shoqeria Digitalb sh.a.

Ndërkaq, rezulton se i padituri në këtë gjykim Alban Jaho, ka ngritur padi, si vijon: Paditës: Alban Jaho; Të Paditur: 1. Shoqëria "DigitAlb" sh.a; 2. Itan Dritan Hoxha; 3. Shoqëria "Loresa"

sh.p.k ; 4. Redia Dritan Hoxha dhe 5. Shoqëria "E&E Investiment" sh.p.k, Me Objekt: 1. Konstatimin e pavlefshmërisë së Vendimit Nr.Extra, datë 17.01.2019 të Aksionarëve të shumicës së asamblesë së përgjithshme për shkarkimin e administratorit, çregjistrimin e këtij vendimi nga Qendra Kombëtare e Biznesit (Regjistrimit) të datës 23.01.2019 dhe urdhërimin e fshirjes së këtij regjistrimi nga aktet e shoqërisë Digitalb të publikuara në regjistrat e Qendrës Kombëtare të Biznesit, si dhe detyrimin e palës së paditur shoqëria "DigitAlb" sh.a, të më rikthejë në poziconin e mëparshëm si administrator; 2.Konstatimi i pavlefshmërisë së Vendimit Nr.Extra datë 17.01.2019 të Aksionarëve të Asamblesë së Përgjithshme për emërimin e Administratorëve të Përkohshëm, çregjistrimin e vendimit nga Qendra Kombëtare e Bisnesit (Regjistrimit) të datës 23.01.2019 dhe urdhërimin e fshirjes së këtij regjistrimi nga aktet e shoqërisë Digitalb të publikuara në regjistrat e Qendrës Kombëtare të Bisnesit; 3. Marrjen e masës së sigurimit të padisë: Pezullimin e zbatimit të sipërcituara (pika 1 dhe 2 më lart) të firmosura nga disa nga Aksionarët e Digitalb sh.a. Urdhërimin e Qendrës Kombëtare të Biznesit (Regjistrimit) të datës 23.01.2019 të realizuara për shkarkimin e administratorit të shoqërisë dhe emërimin e administratorëve të perkohshëm, deri në zgjidhjen e çështjes në themel nga Gjykata; 4. Detyrimin e të paditurit të më paguajë dëmshpërblimin si vijon: - Pagesën e pagës mujore bruto për 16 muaj, për periudhën 17.01.2019 deri më 17.05.2020 për shkak të shkarkimit para përfundimit të mandatit dhe pa arsye të përcaktuara në Ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar) dhe Statutin e shoqërisë "Digitalb" të miratuar me vendimin nr. 6, datë 17.06.2011 (i ndryshuar).Pagesën e dëmshpërblimeve të tjera për mungesën e njoftimit sipas parashikimit në ligje të tjera konkretisht Kodit të Punës për çështje që lidhen me marrëdhëniet e punës, për shpërblimin për vjetërsi dhe pagesën e lejes vjetore të pakonsumuar.- Pagesën e dëmit jopasuror në zbatim të parashikimeve të nenit 625 pika b), nenit 626 dhe nenit 647/a të Kodit Civil; 5. Dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm.

Me vendimin e ndërmjetëm të dt. 04.11.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: Pezullimin e gjykimit të çështjes civile me Nr.Regj.Them 7596, date regjistrimi 03.04.2019 me palë ndërgjyqëse Paditës: Shoqëria "DIGIT-ALB" sh.a; I Paditur: Alban Jaho; me Objekt: - Zhdëmtimin e dëmit 100.000 (njëqind mijë) Euro që ish administratori i shoqërisë "Digitalb" sh.a, Alban JAHO me veprimet dhe vendimarrjet e tij si administrator i ka shkaktuar shoqërisë "Digitalb" sh.a. Lejimin e masës se sigurimit të padisë, duke urdhëruar vendosjen e sekuestros mbi aksionet që Alban Jaho si aksioner ka dhe zotëron në shoqërinë "Digitalb" sh.a, deri në zgjidhjen me vendim gjyqësor të formës së prerë të çështjes civile të regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. 10348 Akti, datë regjistrimi 01.07.2019 me pale ndërgjyqëse dhe objekt: Paditës: Alban Jaho; Të paditur: Shoqëria DigitAlb" sh.a; Itan Dritan Hoxha; Shoqëria "Loresa" sh.p.k; Redia Dritan Hoxha; Shoqëria "E&E Investiment" sh.p.k, me objekt: 1. Konstatimin e pavlefshmërisë së Vendimit Nr.Extra, datë 17.01. 2019 të Aksionarëve të shumicës së asamblesë së përgjithshme për shkarkimin e administratorit, çregjistrimin e këtij vendimi nga Qendra Kombëtare e Biznesit (Regjistrimit) të datës 23.01. 2019 dhe urdhërimin e fshirjes së këtij regjistrimi nga aktet e shoqërisë Digitalb të publikuara në regjistrat e Qendrës

Kombëtare të Biznesit, si dhe detyrimin e palës së paditur shoqëria "DigitAlb" sh.a, të më rikthejë në poziconin e mëparshëm si administrator. 2. Konstatimi i pavlefshmërisë së Vendimit Nr.Extra datë 17.01. 2019 të Aksionareve të Asamblesë së Përgjithshme për emërimin e Administratorëve të Përkohshëm, çregjistrimin e vendimit nga Qendra Kombëtare e Bisnesit (Regjistrimit) të datës 23.01.2019 dhe urdhërimin e fshirjes së këtij regjistrimi nga aktet e shoqërisë Digitalb të publikuara në regjistrat e Qendrës Kombëtare të Bisnesit. ....."

Me kërkesën e prot në gjykatë me nr. 3482 dt. 30.04.2021, pala paditëse, Shoqëria "Digitalb" sha, ka kërkuar rifillimin e gjykimit të kësaj çështje, për shkak se kanë rënë shkaqet për të cilat ajo është pezulluar. Konkretisht, sipas kërkesës, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane me Vendim Nr.4468 date 21.10.2020 ka vendosur: *"Pranimin pjeserisht te padise Detyrimin e pales se paditur Digitalb sh.a. te demshperbleje palen paditese me tre muaj paga mujore si pasoje e zgjidhjes se menjehereshme dhe te pajustifikuar te kontrates se punes Detyrimin e pales se paditur Digitalb sh.a. te demshperbleje palen paditese me tre muaj paga mujore per zgjidhjen e kontrates se punes pa respektuar afatin... Detyrimin e pales se paditur Digitalb sh.a. te demshperbleje palen paditese me dy muaj paga mujore per zgjidhjen e kontrates se punes pa respektuar proceduren... Detyrimin e pales se paditur Digitalb sh.a. ti paguaje pales paditese demshperblimin per vjetersi ne pune... Rrezimin e padise per pjesen tjeter."* Ky vendim ka marre forme te prere ne daten 01.12.2020.

Ne vijim te sa me siper, si dhe ne kushtet kur, shkaku i pezullimit ka rene (Ceshtja civile Nr.10348 2942 Regj.Them. Dt. Regj.01.07.2019 ka perfunduar dhe Vendimi Nr.4468. Date 21.10.2020 ka marre forme te prere ne daten 01.12.2020), ne mbeshtetje te nenit 298 i Kodit të Procedurës Civile, pala paditëse Shoqëria Digitalb sha ka kërkaur vazhdimin e gjykimit te ceshtjes civile Nr.Regj.Them.7596 (Dt.Regj. 03.04.2019).

Nga ana e gjykatës, janë thirrur palët në seancën e dt. 25.10.2021, në të cilën është vendosur rifillimi i gjykimit të çështjes dhe janë ftuar palët e pranishme të paraqesin kërkesa paraprake lidhur me gjykimin. Përfaqësuesi i palës paditëse ka kërkuar heqjen dorë nga masa e sigurimit të kërkuar dhe të vendosur nga ana e gjykatës. Sipas përfaqësuesit të palës paditëse dhe të paditurit janë duke u kryer përpjekje për zgjidhjen me pajtim të çështjes.

Neni 207 i K.Pr.Civile parashikon se gjykata mund të marrë vendim për heqjen e masës së sigurimit, me kërkesën e njërës prej palëve, kur çmon se janë zhdukur kushtet për të cilat ajo është vendosur. Në rastin konkret, në kushtet kur pala paditëse e cila ka kërkuar marrjen e masës kërkon heqjen e saj, gjykata vlerëson se nuk ekzistojnë më shkaqet për të cilat masa e sigurimit është marrë.

Ndërkaq, gjykata vëren dhe faktin se garancisë bankare leshuar nga ''Tirana Bank '' sha me Nr.CO914/170619 date 18.06.2019 për qëllime të vendosjes së kësa mase sigurimi i ka përfunduar afati dhe si rrjedhojë, në kushtet kur nuk është paraqitur garanci e re, konsiderohet e shuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, mbështetur në nenin 125, 202-209 të K.Pr.Civile;

VENDOSI:

1.Pranimin e kerkeses se pales paditese per heqjen e mases se sigurimit te padise te vendosur nga gjykata me vendimin date 14.06.2019.

2. Heqjen e sekuestros konsevative mbi aksionet qe i padituri Alban Jaho zoteron ne shoqerine ''Digitalb'' sha dhe konstatimin e shuarjes se garancise bankare te leshuar nga ''Tirana Bank '' sha me Nr.CO914/170619 date 18.06.2019.

3. Kundër vendimit mund të paraqitet ankim i vecante në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Tiranë, më datë 25.10.2021.

SEKRETARE

GENCJANA DADA

GJYQTARE

ALMA KODRALIU

VËRTETOHET NJESIA
ME ORIGJINALIN
K/ SEKRETARE
ADELA QINARI

PULLE TARIFE
200 LEKË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

TIRANË 22.11.2021.

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

QKB
Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

VENDIM PËR REFUZIMIN E REGJISTRIMIT

Qendra Kombëtare e Biznesit vërteton se me datë 06/01/2020 në bazë të nenit 57 të Ligjit nr. 9723 është refuzuar aplikimi për:

regjistrim fillestar/regjistrime të tjera: Ndryshim Shoqeri Aksionare

paraqitur nga: Elona Brahimi

me numër çështje: CN-444773-12-19

Pasi:

☐ aplikanti nuk ka [ ] plotësuar/ndrequr brenda afatit ligjor elementet që pengojnë regjistrimin, sipas vendimit te QKR datë për pezullimin e aplikimit me numër çështje si me sipër. (Në këtë rast specifikoni referëncën përkatëse mbi të cilën mërret ky vendim)

1. Aplikimi refuzohet pasi nga verifikimi i kryer në Regjistër, figuron: Depozitimi i vendimit Nr.7596, datë 14.06.2019 ku është vendosur: Vendosja e sekuestros konservative mbi aksionet që i padituri Alban Jaho zotëron në shoqërinë "DIGIT-ALB" SHA të shumës prej 20.000 (njëzet mijë) Euro, shumë kjo, e cila duhet të depozitohet nga ana e pales paditëse, shoqërisë DIGIT-ALB" SHA në një nga Bankat e Nivelit të Dytë në Republikën e Shoqërisë për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me përshkrimin: "Për sigurimin e objektit të padisë". Masa e sigurisë të padisë do të shtrijë efektet e veta nga data e depozitimit të shumës së sipërcituar nga pala paditëse shoqëria "DIGIT-ALB" SHA. 17

☐ të dhënat që kërkohen të regjistrohen janë të ndryshme nga të dhënat e regjistrueshme sipas dispozitave të Ligjit nr. 9723 (Në këtë rast specifikoni referëncën përkatëse mbi të cilën mërret ky vendim)

☐ Subjekti ka detyrime tatimore të pashlyera/ gjoba apo interesa të papaguara

me vlefte lek. Për këtë arsye dhe

sipas Seksionit V te Ligjit nr. 9723 datë 3/5/2007 "Për Qendrën Kombetare te Regjistrimit" dhe nenit 32/1 paragrafi 3 i Ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999 "Pëer Prodedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", QKR nuk mund të çregjistroje subjektin nëse organi tatimor kompetent paraqet kundërshtime për çregjistrimin e subjektit.

Data e lëshimit:

23/11/2021

Sporteli i shërbimit:

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

DigitAlb

Autorizim

per te vepruar prane Qendres Kombetare te Biznesit

Une Vjollca Hoxha, ne cilesine e perfaqesueses ligjore te shoqerise Digitalb sh.a me NUIS K41719004D, seli qendrore ne Tirane Kashar, Rruga Pavaresia, nr.39, autorizoj z. Andi Cenko, shtetas shqiptar lindur me 21.04.1984 ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me nr. 024740745 me numer personal I40421056F, qe te paraqitet prane Qendres Kombetare te Biznesit per te kryer cdo procedure te nevojshme lidhur me regjistrimet e meposhtme:

1- Aplikimin per te depozituar Vendimin per marrjen e sigurimit te padise te Gjyqtarit Neritan Cena me nr.[illegible] date[illegible] per vendosjen e mases se sekuestros mbi aksionet qe aksionerit Alban Jaho mban pran Digitalb sh.a.

Cdo veprim I kryer nga I autorizuari prej meje ne funksion te regjistrimeve te sipercituara do te konsiderohet I mireqene sikur te isha une vete. Ne kete kuader, z. Andi Cenko ka te drejte qe te nenshkruaje cdo dokumentacion te nevojshme qe do t'i kerkohet nga Qendra Kombetare e Biznesit me qellimin e regjistrimit te akteve si me siper.

Per Digitalb Sh.a

Vjollca Hoxha

Vjollca Hoxha

Administratore

DigitAlb sha
Administrata Tirane - Durres
Rr. Pavaresia 39
Kashar, Tirane, Shqiperi
Tel: +355 4 2368000
Fax: +355 4 2234931

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

NR.REGJ.THEM 7596
DT.REGJ 03.04.2019 **DT 14.06.2019**

VENDIM
"Për Marrjen e masës së sigurimit të padisë"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej :

NERITAN CENA – GJYQTAR

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Besa Lleshi**, sot në Tiranë më datë 14.06.2019 në vazhdim të seancës përgatitore të çështjes civile me Nr.Regj.Them 7596 që i përket palëve ndërgjyqëse :

PADITËSE : Shoqëria "DIGIT – ALB" sh.a me seli në Tiranë, Kashar, Rruga "Pavarësia" nr. 39, identifikuar nga Nipt me Nr. K 41719004 D përfaqësuar nga znj.Vjollca Hoxha dhe z. Arben Taipi, në cilësinë e administratorëve. e-mail : Vjollca.Hoxha@digitalb.tv përfaqësuar në gjykim me autorizim përfaqësimi me nr. 441 prot datë 01.04.2019 nga z. Redi Lamaj.

I PADITUR: Alban Jaho i biri i Nuriut dhe Nazmies, i dtl 31.05.1969, lindur dhe banues në Tiranë në adresën : Rruga "Vaso Pasha", Pall nr. 31, Apartamenti nr. 4, përfaqësuar në gjykim me deklarim nga av. Neshat Fana me nr. licence 929, nr. nipti L 52212081 M. anëtar i dhomës së avokatisë Tiranë.

OBJEKTI :
- Zhdëmtimin e dëmit 100.000 (njëqind mijë) Euro që ish administratori i shoqërisë "Digitalb" sh.a, Alban JAHO me veprimet dhe vendimarrjet e tij si administrator i ka shkaktuar shoqërisë "Digitalb" sh.a.
- Lejimin e masës së sigurimit të padisë,duke urdhëruar vendosjen e sekuestros mb aksionet që Alban Jaho si aksioner ka dhe zotëron në shoqërinë "Digitalb" sh.a.

BAZA LIGJORE :
- Nenet 14, 16 dhe 163 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregëtare" (i ndryshuar).
- Nenet 32 gërma "a", 154, 202 – 206 të Kodit të Procedurës

Civile.

Në vijim të seancës përgatitore të datës 14.06.2019 nga ana e gjykatës u rrimorr në shqyrtim kërkesa e palës paditëse shoqërisë "Digitalb" sh.a lidhur me marrjen e masës së sigurimit të padisë për urdhërimin e vendosjes së sekuestros mbi aksionet që i padituri Alban Jaho si aksioner zotëronte në shoqërinë "Digitalb" sh.a.
Gjykata pasi dëgjoi pretendimet e përfaqësuesit të palës paditëse shoqërisë "Digitalb" sh.a, z. Redi Lamaj i cili kërkoi pranimin e kërkesës duke vendosur sekuestron konservative mbi aksionet që i padituri Alban Jaho zotëronte në shoqërinë "Digitalb" sh.a. dëgjoi pretendimet e të paditurit Alban Jaho dhe përfaqësuesit të tij av. Neshat Fana të cilët kërkuan rrëzimin e kërkesës. si dhe pasi shqyrtoi provat që ndodhen bashkëlidhur kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë :

VËREN

Se pala paditëse shoqëria "DIGIT - ALB" sh.a rezulton që t'i jetë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë – padi me anë të së cilës ka kërkuar :
I. Zhdëmtimin e dëmit 100.000 (njëqind mijë) Euro që ish administratori i shoqërisë "Digitalb" sh.a, Alban JAHO me veprimet dhe vendimarrjet e tij si administrator i ka shkaktuar shoqërisë "Digitalb" sh.a.
II. Lejimin e masës së sigurimit të padisë. duke urdhëruar vendosjen e sekuestros mbi aksionet që Alban Jaho si aksioner ka dhe zotëron në shoqërinë "Digitalb" sh.a.

Nga provat shkresore që ndodhen në dosje, s'i dhe sipas pretendimeve të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse rezulton se :

1. Referuar përmbajtjes së Ekstraktit Historik të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit shoqërisë "DIGIT – ALB" sh.a rezulton që kjo e fundit të jetë e regjistruar si person juridik që prej datës 18.05.2004 me objekt të veprimtarisë së saj tregtare në fushën e : ***"Ndërtim, tregtim, të sistemeve të telekomunikacioneve...etj"***.
1.1 Referuar përmbajtjes së ekstraktit të sipërcituar rezulton që i padituri në këtë gjykim Alban Jaho të ketë ushtruar funksionin e administratorit të shoqërisë "DIGIT – ALB" sh.a deri më datë 17.01.2019 për shkak se në referim të vendimit të asamblesë së aksionarëve datë 17.01.2019 është vendosur : "Largimi nga detyra e administratorit Z. Alban Jaho".
2. Referuar përmbajtjes së kërkesë – padisë së paraqitur nga pala paditëse shoqëria "DIGIT - ALB" sh.a rezulton që kjo e fundit të ketë pretenduar se i padituri në këtë gjykim Alban Jaho gjatë periudhës që ka ushtruar funksionin e administratorit të shoqërisë i ka shkaktuar dëm shoqërisë "Digit – Alb" sh.a në shumën 100.000 (njëqind mijë) Euro. Sipas pretendimeve të palës paditëse një dëm i tillë ishte shkaktuar si rezultat i faljes së një detyrimi prej 100.000 (njëqind mijë) Euro që i padituri në këtë gjykim Alban Jaho i kishte bërë shoqërisë "Tibo". detyrim ky i cili rridhte nga marrëdhënia kontraktore që shoqëria "Digit – Alb" kishte pasur me shoqërinë "TIBO".
3. Me qëllim për të garantuar të drejtat e saj si palë paditëse ndaj një vendimi të mundshëm që mund të rivendoste të drejtat e palës paditëse shoqërisë "DIGIT - ALB" sh.a përkundrejt të paditurit Alban Jaho nga ana e palës paditëse shoqërisë "DIGIT -

ALB" sh.a rezulton që të jetë kërkuar marrja e masës së sigurimit të padisë duke u vendosur sekuestroja konservative mbi aksionet që i padituri Alban Jaho kishte në shoqërinë "DIGIT – ALB" sh.a. Në kërkesën për vendosjen e një mase të tillë pala paditëse i referohej faktit se nga ana e të padituritë Alban Jaho ishin ndërmarrë veprime konkrete për shitjen e aksioneve që ky i fundit kishte në shoqërinë "DIGIT – ALB" sh.a. Një fakt i tillë sipas pretendimeve të palës paditëse provohej referuar përmbajtjes së emailit – it të datës 21.03.2019 që i padituri Alban Jaho kishte dërguar ndaj aksionerëve të tjerë të shoqërisë "DIGIT – ALB" sh.a me anë të të cilit i padituri Alban Jaho ju kishte ofruar për shitje aksionerëve të tjerë aksionet që ai zotëronte në shoqërinë "DIGIT – ALB" sh.a.

3.1 Sipas pretendimeve të përfaqësuesit të palës paditëse veprimet e ndërmarra nga ana e të padituritë Alban Jaho për shitjen e aksioneve që ai zotëronte në shoqërinë "DIGIT – ALB" sh.a tregonin ekzistencën e rrezikut që nga ana e këtij të fundit mund të kryheshin veprime të tjera të cilat mund të vinin në rrezik ose mund të vështirësonin të drejtat e palës paditëse përkundrejt të padituritë Alban Jaho në rast të një vendimi gjyqësor që do të vërtetonte të drejtat e saj si palë paditëse përkundrejt të padituritë Alban Jaho.

4. Sipas pretendimeve të të padituritë Alban Jaho dhe përfaqësuesit të tij av. Neshat Fana kërkesa e palës paditëse për marrjen e masës së sigurimit të padisë duhet të rrëzohej për arsye se nuk ekzistonte rreziku që i padituri Alban Jaho të tjetërsonte aksionet që ai zotëronte në shoqërinë "DIGIT –ALB" sh.a. si dhe një kërkesë e tillë ishte rrëzuar më parë nga ana e gjykatës bazuar në të njëjtat prova.

Referuar pretendimeve të përfaqësuesit të palës paditëse shoqërisë "DIGIT – ALB" sh.a dhe pretendimeve të të padituritë Alban Jaho dhe përfaqësuesit të tij çështja që do të merret në shqyrtim në rastin konkret nga ana e gjykatës është :

I. Nëse ekzistojnë apo jo kushtet për dhënien e masës së sigurimit të padisë të kërkuar nga ana e palës paditëse, në kuptim kjo të nenit 206 të K.Pr.Civile, s'i dhe në kuptim të vendimit unifikues nr 10, datë 24.03.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Larte :

a) Për vendosjen e masës së sigurimit të padisë duke urdhëruar vendosjen e sekuestros konservative mbi aksionet që i padituri Alban Jaho zotëron në shoqërinë "Digitalb" sh.a?

I. Lidhur me çështjen e shtruar për shqyrtim :

Në nenin 206 gërmat "a" dhe "b" të K.Pr.Civile parashikohet shprehimisht se :

"Sigurimi i padisë bëhet
a) me sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme s'i dhe të kredive të debitorit ;
b) me marrjen nga ana e gjykatës të masave të tjera të përshtatshme, duke përfshirë edhe pezullimin e ekzekutimit....."

Nga përmbajtja e dispozitës së sipërcituar, s'i dhe nenit 202 të K.Pr.Civile rezulton që sigurimi i padisë ka për qëllim të përcaktojë dhe të mbajë përkohësisht të pandryshuar një

situatë faktike apo ligjore të caktuar, në ato raste kur ka arsye të bazuara për të menduar se nga ana e të paditurve apo personave të tretë po kryhen veprime të cilat mund të vështirësojnë apo të bëjnë të pamundur ekzekutimin e të drejtave të paditësit, përpara se të merret një vendim gjyqësor që të vërtetojë të drejtën e paditësit dhe të urdhërojë rivendosjen e saj.

Në të njëjtin përfundim rezulton që të kenë arritur edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 10 datë 24.03.2004, në të cilin ndër të tjera kanë përcaktuar se : ***"Gjykatat, vendimin për marrjen e masës së përkohshme për sigurimin e padisë nuk duhet ta mbështesin në fakte apo veprime, si dhe në cilësimin juridik të tyre, që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes në themel".***

Meqenëse sipas pretendimeve të palës paditëse shoqërisë "DIGIT - ALB" sh.a ekzistojnë arsye të bazuara për të menduar se nga ana e të paditurit Alban Jaho mund të kryhen veprime për tjetërsimin e aksioneve që ky i fundit zotëron në shoqërinë "DIGIT – ALB" sh.a referuar për këtë qëllim emailit të datës 21.03.2019 ekzistonte rreziku që i padituri Alban Jaho të ndërmerrte veprime për shitjen e aksioneve që ai zotëronte në shoqërinë "DIGIT –ALB" sh.a në persona të tretë veprime këto të cilat sipas pretendimeve të palës paditëse shoqërisë "DIGIT - ALB" sh.a do e vështirësonin së tepërmi ekzekutimin e vendimit që mund të jepej në favor të kësaj të fundit, si dhe rivendosja e të drejtave të palës paditëse shoqërisë "DIGIT - ALB" sh.a ndaj të paditurit Alban Jaho mund të paraqitej tepër e vështirë ose e pamundur nga ana e gjykatës vlerësohet se kërkesa e palës paditëse shoqërisë "DIGIT - ALB" sh.a duhet pranuar duke u vendosur sekuestro konservative mbi aksionet që i padituri Alban Jaho ka në shoqërinë "DIGIT –ALB" sh.a duke mos u lejuar tjetërsimi i këtyre aksioneve deri në zgjidhjen e kësaj çështjeje me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Në kushtet kur masa e sigurimit të padisë së kërkuar nga pala paditëse mund të passjellë cënim të interesave të të paditurit Alban Jaho, si dhe në kushtet kur çdo vlerësim qoftë edhe i sipërfaqshëm i provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse në këtë gjykim mund të passillte paragjykim të çështjes objekt gjykimi, s'i dhe me qëllim evitimin e çdo lloj dyshimi nga ana e palëve ndërgjyqëse lidhur me paanësinë e gjykatës në gjykimin e kësaj çështjeje, nga ana e kësaj të fundit në kuptim të nenit 202 germa "b" të K.Pr.Civile, s'i dhe në kuptim të përcaktimeve të vendimit unifikues nr 10, datë 24.03.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, çmohet të kërkohet që nga ana e palës paditëse shoqërisë "DIGIT - ALB" sh.a të depozitohet s'i garanci pasurore shuma prej 20.000 (njëzetë mijë) Euro, shumë kjo e cila do të shërbejë s'i garanci për shpërblimin e dëmit që mund t'i shkaktohet të paditurit në këtë gjykim Alban Jaho në rast se pretendimet e palës paditëse shoqërisë "DIGIT - ALB" sh.a do të rezultojnë të pabazuara. Në vendosjen s'i garanci pasurore të shumës së sipërcituar nga pala paditëse shoqëria "DIGIT - ALB" sh.a nga ana e gjykatës vlerësohet të mbahen parasysh gjendja pasurore e kësaj të fundit, vlera e dëmit të pretenduar nga pala paditëse, si dhe një shumë e tillë nga ana e gjykatës vlerësohet si shumë e mjaftueshme për të garantuar shpërblimin e dëmit që mund t'i shkaktohet të paditurit Alban Jaho nëse do të vërtetohet në përfundim të gjykimit të kësaj çështjeje se pretendimet e palës paditëse përkundrejt të paditurit do të rezultojnë të pabazuara.

Gjykata e gjen të pabazuar pretendimin e parashtruar nga ana e përfaqësuesit të të paditurit Alban Jaho se një kërkesë e tillë është mëzuar më parë nga ana e gjykatës mbi bazën e të njëjtave prova për arsye se emaili i datës 21.03.2019 në të cilin rezulton që të bazohen edhe pretendimet e palës paditëse për marrjen e masës së sigurimit të padisë nuk rezulton që të jetë paraqitur më parë nga ana e kësaj të fundit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata në zbatim të neneve 202 dhe 206 të K.Pr.Civile, s'i dhe në zbatim të vendimit unifikues nr. 10 datë 24.03.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

VENDOSI

- Pranimin e kërkesës së palës paditëse shoqërisë "DIGIT - ALB" sh.a.

I. Vendosjen e sekuestros konservative mbi aksionet që i padituri Alban Jaho zotëron në shoqërinë "DIGIT - ALB" sh.a përkundrejt vendosjes s'i garanci pasurore nga ana e palës paditëse shoqërisë "DIGIT - ALB" sh.a të shumës prej 20,000 (njëzetë mijë) Euro, shumë kjo e cila duhet të depozitohet nga ana e palës paditëse shoqërisë "DIGIT - ALB" sh.a, në një nga Bankat e Nivelit të Dytë në Republikën e Shqipërisë për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me përshkrimin : "Për sigurimin e objektit të padisë".

II. Masa e sigurimit të padisë do të shtrijë efektet e veta nga data e depozitimit të shumës së sipërcituar nga pala paditëse shoqëria "DIGIT - ALB" sh.a.

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 5 (pesë) ditëve, afat i cili si për palën paditëse shoqërinë "DIGIT - ALB" sh.a ashtu edhe për të paditurin Alban Jaho fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

- U shpall në Tiranë sot më datë 14.06.2019.

SEKRETARE

BESA LLESHI

GJYQTAR

NERITAN CENA

PULLE TARIFE

200 LEKË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË